



Scroll down for the English version

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR IDENTIFIKIMIN E VETËM

KUSHTET E PËRGJITHSHME

LEXOJINI ME KUJDES KËTO KUSHTE DHE SIGUROHUNI QË I KUPTONI ATO PËRPARA SE TË AKTIVIZONI DHE PËRDORNI LLOGARINË ME NJË IDENTIFIKIM TË VETËM. KUSHTOJUNI VËMENDJE TË VEÇANTË KUSHTEVE TË PËRDORIMIT NË PARAGRAFIN 3 DHE KUFIZIMEVE TË PËRGJEGJËSISË SONË NË PARAGRAFIN 6.

1. Hyrje

1.1. Ne, Jaguar Land Rover Limited, ofrojmë një shërbim që ju mundëson të krijoni një llogari dixhitale të përgjithshme ("Llogaria SSO") që ju lejon të përdorni të njëjtat të dhëna të identifikimit për të gjitha faqet e internetit, kanalet dhe aplikacionet pjesëmarrëse të JLR-së ("Platformat").

1.2. Mund ta përditësoni dhe menaxhoni Llogarinë SSO, që përfshin të dhënat dhe preferencat tuaja personale, nëpërmjet Platformave.

1.3. Kini parasysh që përdorimi nga ana juaj i Llogarisë SSO është gjithashtu subjekt i sa vijon:

1.3.1. kushteve të përdorimit të faqes sonë të internetit, që mund të gjenden në <https://incontrol.jaguar.com/jaguar-portal-owner-web/about/terms-and-conditions/ALB>, dhe <https://incontrol.landrover.com/jlr-portal-owner-web/about/terms-and-conditions/ALB>, që rregullojnë përdorimin nga ana juaj të faqeve tona të internetit;

1.3.2. politikës sonë të privatësisë, që mund të gjendet dhe shikohet në Platformat përkatëse që po përdorni dhe që përcakton mënyrën se si ne e përdorim çdo informacion që na jepni ndërkohë që përdorni Platformat; dhe

1.3.3. politikës sonë të kukive, që mund të gjendet dhe të shikohet në Platformat përkatëse që po përdorni dhe që përcakton mënyrën se si kukit, sinjalizuesit e uebit dhe teknologji të ngjashme përdoren nga ne ndërsa ju përdorni Platformat.

2. Këto Kushte të Përgjithshme

2.1. Duke u regjistruar për një Llogari SSO ju pranoni të respektoni këto Kushte të Përgjithshme. Nëse nuk dëshironi t'i respektoni këto Kushte të Përgjithshme, mos u regjistroni për një Llogari SSO.

2.2. Ne rezervojmë të drejtën t'i ndryshojmë këto Kushte të Përgjithshme herë pas here.

2.3. Këto Kushte të Përgjithshme duhet të lexohen së bashku me Kushtet e Përgjithshme për



çdo faqe interneti dhe aplikacion të JLR-së. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet këtyre Kushteve të Përgjithshme dhe atyre të një faqeje interneti ose aplikacioni specifik të JLR-së, do t'u jepet përparësi kushteve të faqes së internetit dhe aplikacionit specifik të JLR-së.

2.4. Kushtet tona të Përgjithshme do të jenë në fuqi derisa ta mbyllni Llogarinë SSO ose të ndërpritni të gjitha abonimet në Platformat tona të ndryshme.

3. Kushtet e përdorimit

3.1. Llogaria juaj SSO ofrohet pa pagesë dhe vetëm për përdorim të brendshëm dhe privat. Nuk duhet ta përdorni Llogarinë SSO ose të riprodhoni pjesë të përmbajtjes së ndonjë Platforme për qëllime tregtare, biznesi ose rishitjeje dhe ne nuk kemi asnjë përgjegjësi ndaj jush për çfarëdolloj humbjeje biznesi.

3.2. Duke përdorur Llogarinë SSO, ju garantoni se:

3.2.1. nuk do ta përdorni Llogarinë SSO në mënyra që nuk janë në përputhje me këto Kushte të Përgjithshme ose në një mënyrë që shkel ligjet ose rregulloret vendore, kombëtare ose ndërkombëtare;

3.2.2. nuk do të lejoni askënd tjetër të përdorë Llogarinë tuaj SSO;

3.2.3. nuk do të shkelni të drejtat tona të pronësisë intelektuale ose ato të një pale të tretë në lidhje me përdorimin nga ana juaj të Llogarisë SSO.

3.3. Në rast se shkelni ndonjë prej këtyre Kushteve të Përgjithshme ose dyshojmë për keqpërdorimin e kredencialeve të identifikimit ose Llogarisë suaj SSO, ne kemi të drejtën ta mbyllim Llogarinë tuaj SSO dhe t'ju mohojmë aksesin në Platformat tona. Gjithashtu, rezervojmë të drejtën t'ju bëjmë përgjegjës për të gjitha pasojat e këtij keqpërdorimi.

3.4. Nëse nuk i zbatojmë të drejtat tona kundrejt jush ose nëse vonojmë ta bëjmë këtë gjë, kjo nuk do të thotë se kemi hequr dorë nga të drejtat tona ose nuk do të thotë që ju mund t'i shkelni detyrimet tuaja, qoftë në këtë rast ose në të ardhmen.

3.5. Ne kemi të drejtën ta mbyllim menjëherë Llogarinë tuaj SSO nëse ndërpresim ofrimin e shërbimit me identifikim të vetëm për çfarëdolloj arsyeje.

4. Regjistrimi dhe disponueshmëria

4.1. Informacioni personal që jepni në momentin e regjistrimit duhet të jetë i vërtetë dhe i saktë dhe duhet ta përditësoni këtë informacion në rast ndryshimesh. Mbajini të gjitha kredencialet e identifikimit konfidenciale dhe mos ia zbuloni askujt për të parandaluar përdorimin e paautorizuar të Llogarisë suaj SSO.



4.2. Ne rezervojmë të drejtën të refuzojmë regjistrimet për një Llogari SSO sipas rastit.

4.3. Megjithëse do të bëjmë përpjekjet tona të arsyeshme për të mirëmbajtur shërbimet dhe komunikimet dhe për ta mbajtur përmbajtjen të përditësuar, ne nuk mund të garantojmë aksesueshmërinë në Platformat tona, as nuk bëjmë premtime lidhur me saktësinë ose plotësinë e përmbajtjes ose informacionit që përmbajnë ato.

4.4. Shërbimi me identifikim të vetëm ofrohet siç është. Ne nuk mund të garantojmë që ai nuk do të përmbajë gabime ose që do të jetë vazhdimisht i disponueshëm. Shërbimi me identifikim të vetëm mund të jetë objekt i periudhave të shkëputjeve dhe/ose inaktivitetit gjatë periudhës së mirëmbajtjes ose modifikimit, ose i ndërprerjeve të shërbimeve të komunikimit dhe mediave të palëve të treta.

4.5. Ne mund të bëjmë ndryshime në shërbimin me identifikim të vetëm kur ka ndryshim të ofruesve të shërbimit, kur ekziston një ndryshim rregullator ose ligjor që na detyron të bëjmë një ndryshim ose të ndryshojmë funksionalitetin dhe të bëjmë përmirësime. Nëse këto ndryshime nuk janë të pranueshme për ju, mund të mbyllni Llogarinë SSO në çdo kohë.

4.6. Duke përdorur Llogarinë tuaj SSO ju kuptoni dhe pranoni rrezikun dhe kufizimet e internetit, por ne do të bëjmë përpjekje të arsyeshme për t'u përgjigjur për çdo problem që silllet në vëmendjen tonë.

5. Të drejtat e pronësisë intelektuale

5.1. Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale duke përfshirë, në masën e zbatueshme, të drejtën e autorit, markat tregtare, të drejtat e dizajnit ose të drejta të tjera të pronësisë intelektuale të regjistruara ose jo, zotërohen nga ne ose na janë dhënë me licencë, nëse nuk tregohet ndryshe.

5.2. Përveçse për përdorimin e Llogarisë suaj SSO në përputhje me këto Kushte të Përgjithshme, ju nuk përfitoni të drejta për të përdorur ose, ndër të tjera, për të kopjuar, modifikuar, transmetuar, shpërndarë, paraqitur, riprodhuar, publikuar, licencuar ose përdorur në ndonjë mënyrë pronësinë intelektuale që përmbajnë Platformat tona pa pëlqimin tonë paraprak me shkrim.

6. Kufizimet e përgjegjësisë

6.1. Ne jemi përgjegjës për humbjet ose dëmet që pësoni që janë rezultat i parashikueshëm i shkeljes nga ana jonë të këtyre Kushteve të Përgjithshme ose neglizhencës sonë, por ne nuk jemi përgjegjës për humbjet ose dëmet e paparashikuara.

6.2. Ne nuk do të mbajmë përgjegjësi në asnjë formë për humbjet e tërthorta ose shkakësore, duke përfshirë humbjen financiare, dëmtimin e reputacionit ose humbjen e të dhënave. Ne nuk



do të mbajmë përgjegjësi për humbjet e biznesit të asnjë lloji.

6.3. Ne nuk do të jemi përgjegjës për pamundësinë ose vonesën në përbushjen e detyrimeve tona sipas këtyre Kushteve të Përgjithshme për çdo rast jashtë kontrollit tonë që përfshin, ndër të tjera, grevat, bllokimet e punës ose veprime të tjera sindikale nga palë të treta, trazira civile, manifestime, pushtime, sulme terroriste ose kërcënime për sulme terroriste, luftë (qoftë ajo e shpallur apo jo) ose kërcënim apo përgatitje për luftë, si dhe zjarre, shpërthime, stuhi, përmbytje, tërmete, rrëshqitje dherash, epidemi ose fatkeqësi të tjera natyrore, defekte në rrjetet publike ose private të telekomunikacionit, veprimet ose mosveprimet nga autoritetet ligjzbatuese ose shërbimet e emergjencës.

6.4. Ne nuk e përjashtojmë ose kufizojmë përgjegjësinë tonë për vdekjen ose lëndimet personale të shkaktuara nga neglizhenca jonë, mashtrimet ose pretendimet e rreme ose për çdo çështje tjetër për të cilën do të ishte e paligjshme ose e jashtëligjshme të përjashtonim ose të tentonim të përjashtonim përgjegjësinë tonë.

6.5. Asnjë pjesë e këtyre Kushteve të Përgjithshme nuk do të ndikojë në të drejtat tuaja ligjore si konsumator.

7. Kushte të tjera të rëndësishme

7.1. Secila prej dispozitave në këto Kushte të Përgjithshme funksionon në mënyrë të pavarur. Nëse ndonjë prej dispozitat përcaktohet si e paligjshme, e pavlefshme ose përndryshe e pazbatueshme, dispozitat e mbetura do të mbeten në fuqi dhe në efekt të plotë.

7.2. Këto Kushte të Përgjithshme rregullohen nga ligjet e Anglisë dhe Uellsit. Kjo do të thotë se çdo mosmarrëveshje ose pretendim që lind nga ose në lidhje me këto Kushte të Përgjithshme do të rregullohet nga legjislati i Anglisë dhe Uellsit dhe gjykatat e Anglisë dhe Uellsit do të kenë juridiksionin ekskluziv, përveç nëse jeni banor në Irlandën e Veriut ose Skoci ju mund t'i inicioni procedurat në Irlandën e Veriut ose Skoci (sipas rastit).

SINGLE SIGN ON TERMS & CONDITIONS

PLEASE READ THESE TERMS CAREFULLY AND MAKE SURE YOU UNDERSTAND THEM BEFORE ACTIVATING AND USING YOUR SINGLE SIGN-ON ACCOUNT. IN PARTICULAR YOUR ATTENTION IS DRAWN TO THE TERMS OF USE IN PARAGRAPH 3 AND OUR LIMITATIONS OF LIABILITY IN PARAGRAPH 6.

1. Introduction

1.1. We, Jaguar Land Rover Limited, offer a service which enables you to create a generic



digital account ("SSO Account") which allows you to use the same login data for all participating JLR websites, channels and applications ("Platform(s)").

1.2. You may update and manage your SSO Account which includes your personal details and preferences through the Platform(s).

1.3. Please note that your use of the SSO Account is also subject to the following:

1.3.1. our website terms of use, which can be found at, <https://incontrol.jaguar.com/jaguar-portal-owner-web/about/terms-and-conditions/ALB> and <https://incontrol.landrover.com/jlr-portal-owner-web/about/terms-and-conditions/ALB>, which govern your use of our websites;

1.3.2. our privacy policy, which can be found and viewed on the relevant Platform(s) you are accessing, and which sets out how we use any information you provide to us whilst using the Platform(s); and

1.3.3. our cookies policies, which can be found and viewed on the relevant Platform(s) you are accessing, and which sets out how cookies, web beacons and similar technologies are used by us as you use the Platform(s).

2. These Terms and Conditions

2.1. By registering for a SSO Account you are agreeing to be bound by these Terms and Conditions. If you do not wish to be bound by these Terms and Conditions, please do not register for a SSO Account.

2.2. We reserve the right to change these Terms and Conditions from time to time.

2.3. These Terms and Conditions should be read alongside the Terms and Conditions for each JLR website and application. In the event of any inconsistency between these Terms and Conditions and those of a specific JLR website or application, the terms of such specific JLR website or application shall prevail.

2.4. Our Terms and Conditions shall take effect until you terminate your SSO Account or otherwise end all subscriptions to our various Platform(s).

3. Terms of use

3.1. Your SSO Account is provided free of charge and for domestic and private use only. You must not use your SSO Account or reproduce any of the content contained in any Platform(s) for any commercial, business or re-sale purpose and we have no liability to you for any business losses whatsoever.

3.2. By using the SSO Account, you warrant that you will not:



3.2.1. use the SSO Account in a manner inconsistent with these Terms and Conditions or in any way that breaches any local, national or international laws or regulations;

3.2.2. permit anyone else to use your SSO Account;

3.2.3. infringe our intellectual property rights or those of any third party in relation to your use of the SSO Account.

3.3. In the event you breach any of these Terms and Conditions or we suspect misuse of your login details or your SSO Account, we shall have the right to terminate your SSO Account and deny you access to any Platform(s). We also reserve the right to hold you liable for all consequences of such misuse.

3.4. If we do not enforce our rights against you, or we delay in doing so, that does not mean we have waived our rights or that you do not have to comply with any of your obligations, either in the instant case or in the future.

3.5. We are entitled to immediately terminate your SSO Account if we stop providing the single sign-on service for any reason.

4. Registration and availability

4.1. The personal information you provide upon registration must be true and correct and you must update such information in the event it changes. Please keep all login details confidential and do not disclose your login details to anyone to prevent unauthorised use of your SSO Account.

4.2. We reserve the right to refuse registrations for a SSO Account on a case by case basis.

4.3. While we shall use our reasonable endeavours to maintain services and communications, and keep content up to date, we are unable to guarantee the accessibility of any of our Platform(s), nor do we make any promises about the accuracy or completeness of the content or information contained within.

4.4. The single sign on service is provided as is, we cannot guarantee that it will be error free or continuously available. The single sign on service may be subject to periods of disruption and/or downtime during period of maintenance or modification, or interruption to third party media and communications.

4.5. We may make changes to the single sign on service where there is a change to our service providers, where there is a regulatory or legal change which requires us to make a change or to amend functionality and make improvements. If these changes are not acceptable to you, you may close your SSO Account at any time.

4.6. By using your SSO Account you acknowledge and accept the risk and limitations of the



internet, but we shall use reasonable endeavours to respond to any issues that are brought to our attention.

5. Intellectual Property

5.1. All intellectual property rights including, to the extent applicable, copyright, trademarks, design rights, patents or other intellectual property rights whether registered or not, are owned by or licensed to us unless otherwise indicated.

5.2. Except for use of your SSO Account in accordance with these Terms and Conditions, you are granted no rights to use or, without limitation, copy, modify, transmit, distribute, display, reproduce, publish, licence or in any way use any of the intellectual property contained within any of our Platform(s) without our prior written consent.

6. Limitations of Liability

6.1. We are responsible for any loss or damage you suffer that is a foreseeable result of our breach of these Terms and Conditions or our negligence but we are not responsible for any loss or damage that is not foreseeable.

6.2. We shall not be liable for any form of indirect or consequential loss including financial loss, damage to reputation or loss of data. We shall not be liable for any business losses of any nature.

6.3. We shall not be liable or responsible for any failure to perform or any delay in performance of any of our obligations under these Terms and Conditions for any event outside our control which includes, without limitation, strikes, lock-outs or other industrial action by third parties, civil commotion, riot, invasion, terrorist attack or threat of terrorist attack, war (whether declared or not), or threat or preparation for war, fire, explosion, storm, flood, earthquake, subsidence, epidemic or other natural disaster, failure or interruption of public or private telecommunications networks or acts or omission of any law enforcement authority or the emergency services.

6.4. We do not exclude or limit our liability for death or personal injury caused by our negligence, fraud or fraudulent misrepresentation or for any other matter for which it would be illegal or unlawful for us to exclude or attempt to exclude or liability.

6.5. Nothing in these Terms and Conditions shall affect your statutory rights as a consumer.

7. Other important terms

7.1. Each of the provisions in these Terms and Conditions operates separately. If any provisions are determined to be illegal, invalid or otherwise unenforceable then the remaining provisions shall remain in full force and effect.

7.2. These Terms and Conditions are governed by the laws of England and Wales. This means



any dispute or claim arising out of or in connection with these Terms and Conditions will be governed by the laws of England and Wales and the courts of England and Wales shall have exclusive jurisdiction save for if you are resident in Northern Ireland or Scotland you may bring proceedings in Northern Ireland or Scotland (as applicable).